



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:148590

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05496678

Rev.nr.15/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Beshir Islami, anëtar, në çështjen juridike të paditësit A.L., nga fshati P., Komuna H i E., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mimoza Kuka Bushi, avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P”, me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Nderim Musa, avokat nga Ferizaj, me objekt kontesti kompensim dëmi material - rentë mujore, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.1244/2022 të datës 07.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “P”., me seli në P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AC.nr.1244/2022 të datës 07.09.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.168/19 të datës 13.01.2022, në pikën I të dispozitivit është miratuar në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.L.,nga ..., Komuna H. E., dhe është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “P”., me seli

në P., që paditësit t'ia paguaj rentën siç vijon: I/a Për periudhën e kaluar prej datës 16.07.2020, e deri më 30.09.2021, datën kur është bërë ekspertiza, t'ia paguaj shumën prej 14,602.89 €, si dhe kamatën për këtë periudhë kohore në shumë prej 4,211.56 €, e gjithsej për pagesë shumën prej 18,814.45 €. I/b Për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.10.2021, e deri më datën 16.07.2022 shumën mujore prej 204 €, ndërsa nga data 17.07.2022 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, shumën prej 136.00 €, e cila pagesë do të bëhet më së voni deri më datën 5 të muajit të ardhshëm për secilin këst të arritur për pagesë. Mirëpo e paditura këto shuma mund ti paguaj në formë të kapitalizuar edhe atë në shumë të tërsishme 47,928.55 €. Në pikën II të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën në pikën I/a dhe I/b si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,418.00 €, të gjitha këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AC.nr.1244/2022 të datës 07.09.2023, është refuzuar e pabazë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "P", me seli në P., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.168/19 i datës 13.01.2022.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të pranoj revizionin e të paditurës, të ndryshoj aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, ashtu që të refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, apo aktgjykimet e njëjta të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

E autorizuar e paditësit ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e të paditurës ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të paditurës, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi përmes të autorizuarës së tij, me padi dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ka kërkuar kompensim të dëmit material – rentës, për periudhën e kaluar dhe të ardhshme, sipas precizimit të bërë me datë 01.10.2021.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të administruara ka miratuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me vlerësim se paditësi në aksidentin e komunikacionit të datës

16.07.2016 ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë me lëshimet e drejtuesit të automjetit të siguruar te e paditura, ndërsa si rezultat i këtij lëndimi paditësit i është zvogëluar aftësia për punë e përhershme në shkallë prej 40%, e që ka rezultuar në dëm material në formë të fitimit të humbur-rentës, vlera e të cilit arrin shumën prej 47,928.55 € (e kapitalizuar), ashtu siç është përcaktuar me ekspertizën e akuaristikës.

Mbi këtë bazë është detyruar e paditura që për periudhën e kaluar, duke filluar nga data 16.07.2020 e deri më datën 30.09.2021 paditësit t'ia paguaj shumën prej 18,814.45€, në këtë shumë është e përfshirë edhe kamata në shumë prej 4,211.56 €. Ndërsa për periudhën e ardhshme prej datës 01.10.2021 e deri më datën 16.07.2021 t'ia paguaj shumën mujore prej 204 €, ndërsa nga data 17.07.2022 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore shumën prej 136 €. Këto shuma gjykata i ka caktuar duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit aktuar, i cili në mënyrë detajuar ka sqaruar dëmin të cilin e ka pësuar paditësi, e kësaj ekspertize gjykata e shkallës së parë ja ka falë besimin, me vlerësim se është punuar në mënyrë profesionale dhe nuk është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kjo e drejtë i takon paditësit pasi që kompensimi për rentë nuk është vendosë me aktgjykimin C.nr.246/16 të datës 21.11.2017. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 136.1 dhe 172 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, si dhe neni 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës së të paditurës ka refuzuar si të pabazuar ankesën, ndërsa ka vlerësuar se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragrafi 2 pika n), lidhur me neni 160 paragrafi 4 të LPK-së, ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe në harmoni të plotë me arsyetimin e dhënë e në të cilin arsyetim janë dhënë arsye konkrete për faktet relevante me rëndësi vendimtare, të cilat e kanë shtyrë gjykatën e shkallës së parë për të marrë një vendim të tillë.

Kjo gjykatë ka vlerësuar të pabazuar edhe pretendimin ankimor të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë si rezultat i konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe si pasojë e kësaj edhe me interpretim dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike duke u bazuar në provat e administruara, të cilat gjenden në shkresa të lëndës, e nga të cilat vërtetohet se kjo çështje juridike që ka të bëjë me dëmin material, përkatësisht rentën mujore të paditësit, nuk mund të ndërlidhet në asnjë mënyrë me ujdinë jashtëgjyqësore dhe as aktgjykimin C.nr.246/2013 të datës 21.11.2017. Sipas kësaj gjykate, në asnjë rrethanë nuk mund të thuhet se është konsumuar e

drejta subjektive e paditësit, për të kërkuar rentën në këtë kontest duke ju referuar ujdisë nr. 1059/16 të datës 27.12.2017, e nënshkruar në mes palëve, e që ka të bëjë me kompensimin e njohur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.246/16 të datës 21.11.2017. Kjo gjykatë ka vlerësuar se ujdia në fjalë ka të bëjë vetëm me objektin e kontestit të aktgjykimit të sipërcituar, ku palët e ujdisë nuk e kanë pritur përmbartimin e tij përmes procedurës përmbartimore, por këtë e kanë arritur me ujdi jashtëgjyqësore, e në të cilin aktgjykim nuk ka qenë objekt kontesti kompensimi i rentës për paditësin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë në këtë çështje kontestuese të paditësit i referohet dispozitave ligjore nga neni 136.1 të LMD-së, ku në mënyrë shprehimore përcaktohet baza e përgjegjësisë, ashtu që “kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Ndërkaq, me dispozitat e nenit 172 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, është përcaktuar edhe shpërblimi i dëmit në formë të rentës në të holla. Prandaj, konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Pala e paditur në revizionin e paraqitur pretendon se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të nenit 194 të LPK-së, për faktin se ankesën nuk e ka ekzaminuar në të gjitha pjesët e goditura nga pala e paditur. Gjykata Supreme e ka vlerësuar të pabazuar një pretendim të tillë pasi që nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, rezulton se kjo gjykatë ka trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga e paditura dhe ka dhënë arsye të qarta në lidhje me çështjet e ngritura që kanë të bëjnë me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale. Gjykata e shkallës së dytë me arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar me revizion ka përmbushur kërkesat ligjore nga neni 204 të LPK-së, si në pikëpamje të kufijve të shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe në aspektin e dhënies së arsyeve për të gjitha çështjet e ngritura në ankesë.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me bazën e përgjegjësisë, për kompensim të dëmit, ndërsa për çështjen e ujdisë jashtëgjyqësore qartë është deklaruar se kjo nuk përfaqëson çështje të mbyllur në lidhje me kërkesën për kompensim të dëmit material në emër të rentës, kjo pasi që ujdia jashtëgjyqësore

që është lidhur mes palëve ndërgjyqëse për objekt ka pasur kompensimin e dëmit që paditësit i është njohur me aktgjykimin C.nr.246/16 të datës 21.11.2017, ndërsa kjo kërkesë nuk ka qenë objekt i pajtimit në fjalë. Në lidhje me lartësinë e kompensimit gjykatat kanë dhënë arsye të qarta ku shkalla e zvogëlimit të aftësisë punuese është përcaktuar me ekspertizë të ekspertit mjekësor të punës, ndërsa përmes ekspertizës së aktuaristikës është caktuar kompensimi në emër të dëmit material që ka të bëjë me rentën.

Në revizionin e paraqitur pala e paditur pretendon se gjykata e shkallës së dytë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, por vetëm duke cituar dispozitën e nenit 172 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, kjo pasi që palët ndërgjyqëse më parë kanë lidhur ujdi jashtëgjyqësore, sipas së cilës ujdi me pikë të veçantë është përcaktuar se: “personi i dëmtuar nuk do të ketë kurrfarë kërkesash të mëvonshme sa i përket dëmit të pësuar ndaj KS “P”., e as ndaj pronarit/shfrytëzuesit të veturës”. Gjykata Supreme ka vlerësuar një pretendim të tillë mirëpo për këtë çështje ka mbështetur qëndrimin e dy gjykatave të instancës më të ulët, pasi që nuk ekziston asnjë bazë ligjore që paditësin ta privon nga e drejta në kompensim të dëmit material - rentës. Me të drejtë është vlerësuar se kërkesa për rentë nuk ka qenë pjesë e kërkesës së padisë fillestare që është mbyllë me aktgjykimin C.nr.246/16 të datës 21.11.2017, ku më pas kërkesat që kanë derivuar nga ky aktgjykim janë përfshi në ujdinë jashtëgjyqësore që është lidhur mes palëve ndërgjyqëse. Ujdia jashtëgjyqësore i referohet kërkesave që janë gjykuar me aktgjykimin e sipërtheksuar dhe çdo heqje dorë nga ndonjë kërkesë duhet interpretuar që ka të bëjë me kërkesat, për të cilat ka pasur vendim gjyqësor dhe është arritur ujdia mes palëve, por asnjëherë për kërkesat që nuk kanë qenë pjesë e ndonjë procesi të mëhershëm. Përvec kësaj, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë trajtuar çështjen sipas dispozitave nga nenet 1052 dhe 1047 të LMD-së, kjo pasi që pala paditëse nuk ka kërkuar anulim të ujdisë, por se kërkesa ka qenë kompensimi i një kategorie të dëmit e cila nuk ka qenë pjesë e ujdisë jashtëgjyqësore. Meqë kërkesa nuk ka qenë pjesë e ujdisë, atëherë ujdia jashtëgjyqësore nuk ka krijuar asnjë pasoj juridike në raport me kërkesën e paditësit për kompensim të dëmit material- rentës.

Sa i përket bazës juridike të përgjegjësisë, të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë e që është pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, Gjykata Supreme e pranon qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta duke vlerësuar se për përgjegjësinë e të paditurës në kompensim të dëmit material – rentës paditësit, të konstatuar në aktgjykim të shkallës së parë e të pranuar nga gjykata e shkallës së dytë, janë dhënë arsye të qarta dhe të mbështetura në prova të administruara, posaçërisht ekspertiza e komunikacionit nga e cila ka rezultuar se aksidenti i komunikacionit i datës 16.07.2016 është shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës, ndërsa paditësi ka pësuar

lëndime të rënda. Gjykata Supreme vlerëson se paditësit i takon kompensimi si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, bazuar posaçërisht në përfundimet e nxjerra nga eksperti i mjekësisë së punës, ku në mënyrë të qartë është konstatuar se paditësit i është zvogëluar aftësia e përhershme për punë në shkallë prej 100% gjatë dy viteve të para pas aksidentit, pastaj 60% gjatë katër viteve të tjera si dhe 40% ka zvogëlim të aktivitetit punues në punët e elektroinstaluesit. Eksperti i aktuaristikës duke marrë për bazë shkallën e zvogëlimit të aktivitetit punues të konstatuar nga eksperti mjekësor, pastaj faktin që paditësi ka qenë i pakualifikuar, llogaritjen e fitimit të humbur e ka bërë duke marrë për bazë të ardhurat mesatare të punësuarve të pakualifikuar- fizik në Kosovë. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme gjykatat e instancës më të ulët duke marrë për bazë ekspertizën mjekësore të ekspertit të punës dhe atë të aktuaristikës, të cilat ekspertiza kanë vërtetuar faktet kryesore të çështjes, drejtë kanë aplikuar dispozitat nga neni 172 të LMD-së, ku është vendosur për shumat e gjykuara në emër të dëmit material për fitimin e humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues, qoftë sa i përket rentës së arritur por edhe rentës për periudhën e ardhshme.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij revizioni, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.15/2024, më 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Zenel Leku